



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 465/9 prot.

Tiranë, më 13.07.2021

VENDIM

Nr.98, datë 13.07.2021

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMIT
TË KOMISIONERIT NR. 77, DATË 16.06.2021**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 77, datë 16.06.2021, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së procesit të vlerësimit periodik, Korrik- Dhjetor 2020, të nëpunëses *****”, me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Financës, në institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.”

KONSTATOVA SE:

Nëpunësja civile ***** , nëpërmjet një kërkesë të regjistruar pranë Komisionerit me nr. 465 prot., datë 13.04.21, ka ngritur disa pretendime për parregullsi të kryera ose të lejuara në procesin e vlerësimit të rezultateve në punë, për periudhën e vlerësimit 1 Korrik- 31 dhjetor 2020.

Për verifikimin e informacionit, Komisioneri ka kryer hetimin administrativ të këtij rasti, duke kërkuar nga institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit të dërgojë të gjithë dokumentacionin që disponon në lidhje me këtë rast.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 77, datë 16.06.2021, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së procesit të vlerësimit periodik, Korrik- Dhjetor 2020, të nëpunëses *****”, me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Financës, në institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, njësia përgjegjëse pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues, duke bashkëngjitur dokumentacionin që provon zbatimin e tij.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr.77, datë 16.06.2021, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, situata e administrimit të shërbimit civil për rastin në fjalë në Kontrollin e Lartë të Shtetit paraqitet si më poshtë vijon:

Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse në Kontrollin e Lartë të Shtetit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë, të veprjës sipas masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit nr.77, datë 16.06.2021, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Vërej se, në zbatim të dispozitivit të vendimit nr. 77, datë 16.06.2021, Kontrolli i Lartë i Shtetit, me shkresën nr. 64/8 prot., datë 07.07.2021, ka informuar Komisionerin për masat e marra për zbatimin e vendimit paralajmërues. Konkretisht, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me vendimin nr. 75, datë 25.06.21, ka anuluar aktin e vlerësimit/rivlerësimit të nëpunës ***** dhe ka vendosur përsëritjen e procesit të vlerësimit për këtë nëpunës për periudhën 01.07.20-31.12.20.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 77, datë 16.06.21, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së procesit të vlerësimit periodik, Korrik- Dhjetor 2020, të nëpunës ***** , me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Financës, në institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.”
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, duke zbatuar rekomandimet e vendimit nr.77, datë 16.06.2021.

3. Për këtë vendim të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe nëpunësja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha